



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:000588

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05781517

C.nr.1556/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Berkan Hamza dhe me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: I.K, F.S dhe P.A, që të tre nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.M, avokat në Rahovec, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,272.77 euro, jashtë seance me datë 05.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: I.K, F.S dhe P.A.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.K nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 102.81 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022 në shumën prej euro 312.78, në shumën e përgjithshme prej 415.59 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 26.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit F.S nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 102.81 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022 në shumën prej euro 312.78, në shumën e përgjithshme prej 415.59 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 26.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit P.A nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 102.81 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022 në shumën prej euro 312.78, në shumën e përgjithshme prej 415.59 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë

26.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit I.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 415.59 euro e deri në shumën 757.59 euro, dhe atë në shumën prej 342.00 euro.

VI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit F.S, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 415.59 euro e deri në shumën 757.59 euro, dhe atë në shumën prej 342.00 euro.

VII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit P.A, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 415.59 euro e deri në shumën 757.59 euro, dhe atë në shumën prej 342.00 euro.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve: I.K, F.S dhe P.A ti paguaj shumën prej 177.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Paditësit I.K, F.S dhe P.A në këtë gjykatë me datë 26.12.2022, përmes të autorizuarit të tyre A.M, avokat në Rahovec, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, e cila e drejtë nuk i është realizuar asnjëherë paditësve. Andaj gjykatës i kanë propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore dhe mungesë së legjitimitetit të palës nënshkruese. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Selajdin Mullabazi - Mici”, në Rahovec. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve është në shumën prej 252.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve I.K, F.S dhe P.A i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II. III. dhe IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve në pjesën tjetër, pasi që paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit në bazë të pagës bazë (252 euro) dhe jo siç pretendojnë paditësit në bazë të pagës bazë (421 euro). Po ashtu paditësit

kanë kërkuar kompensimi nga data 01.01.2021 – 31.12.2022, mirëpo sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, realizimi i të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021, duhet të trajtohen deri më datën 21.11.2022, kur edhe është shkëputur kjo kontratë nga njëra palë kontaktuese. Andaj gjykata vendosi si në pikën V. VI dhe VII. të dispozitivit të këtij aktgjykim duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuqjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 177.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.1556/2023, më datën 05.06.2024

Bashkëpunëtore profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.